

VENDIM
Nr. 801, datë 29.12.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I PIKËS
SË KALIMIT KUFITAR TË PËRBASHKËT
MORINË – VËRMICË, KUKËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i pikës së kalimit kufitar të përbashkët Morinë – Vërmicë, Kukës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 41 976 (dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) m², me vlerë shpronësimi 20 724 (njëzet mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë;

b) tokë “arë”, me sipërfaqe 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) m², me vlerë shpronësimi 21 252 (njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 41 976 (dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.

5. Pronarët e pasurive, që shpronësohen sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE PRIVATË QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË PIKËS
SË KALIMIT TË PËRBASHKËT MORINË – VËRMICË, BASHKIA KUKËS

Fshati	Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale, lekë	Lloji i vërtetimit
M o r i n ë	1	Rive Iljaz Duraku	2724	91/16	Arë	157	132	20,724	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	2	Rive Iljaz Duraku	2724	83/17	Arë	161	132	21,252	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		SHUMA				318	132	41,976	